



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.190 dt.15.12.1997

**PER MIRATIM TE NDRYSHIMIT TE KOHES DHE QELLIMIT TE DISA
PROJEKTEVE KULTURORE**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin e Drejtorisë të Kulturës, Arsimit e Sportit, mbi organizimin e veprimtarive kulturore “Ditët e Bashkëpunimit Kulturor ITALO SHQIPTARE” në datat. 05, 06, 07 Dhjetor 1997 në Tiranë mbështetur në ligjin Nr.7572, neni.45, pika.16

VENDOSI

- **Projekti kulturor Nr.9** “Sofra Tiranase me **shumën 400 mijë lekë**.
- **Projekti kulturor Nr.13** “Mbrëmje artistike të verës me **shumën 400 mijë lekë**.
- **Projekti kulturor Nr.24** Konkursi i parë i koreve “TIRANA 2000” me **shumën 300 mijë lekë**.
- **Projekti kulturor Nr.25** Autorë librash me **shumën 75 mijë lekë** të miratuara me vendim të Këshillit Bashkiak Nr.114, dt.17.06.1997.

- Këto projekte kulturore të vihen në dispozicion për realizimin Ditët e Bashkëpunimit kulturor ITALO SHQIPTARE me **shumën 1.175.000 lekë**.

- Gjithashtu projekti kulturor Nr./ 10 – Turneu i grupit “Të rinjtë e Tiranës” që do të shkonte në muajin Qershor në Angli dhe nuk u realizua për arsye të situatës – miratohet për tu realizuar në MALTE në festivalin folklorik ndërkombëtar 26 Dhjetor 1997 deri 2 Janar 1998, **shuma 6.500 lekë**

- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kulturës, Arsimit e Sportit dhe Drejtoria e Financës.

- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI
ORHAN SAKIQI**

